

VENDIM
Nr. 312, datë 15.4.2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.942, DATË 9.10.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE
TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.942, datë 9.10.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:
Pas pikës 3, shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:
“3.1 Ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe ndërtimeve.”.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama